



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 04, datë 13.01.2020

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“RIKONSTRUKSION I AMBIENTEVE TË GJYKATËS PËR KRIMET E RËNDA DHE
PROKURORISË PËR KRIMET E RËNDA”, ME QËLLIM KRIJIMIN E MJEDISEVE TË
PËRSHTATSHME TË PUNËS, PËR GJYKATAT KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT
TË ORGANIZUAR DHE PROKURORINË E POSAÇME”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të nenit 57, të Ligjit Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rikonstruksion i ambienteve të Gjykatës për Krimet e Rënda dhe Prokurorisë për Krimet e Rënda, me qëllim krijimin e mjediseve të përshtatshme të punës për Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokurorinë e Posaçme”, Bashkia Tiranë, me zhvillues Ministrinë e Brendshme.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit teknik;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I BRENDSHËM

SANDËR LLESHAJ



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

